



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

Numri i lëndës : KSC-BC-2023-12

**Prokurori i Specializuar k. Hashim Thaçit, Bashkim Smakajt,
Isni Kilajt, Fadil Fazliut dhe Hajredin Kuçit**

Vendosi: Gjykatësja e Procedurës Paraprake

Gjykatëse Marzhori Masëlo

Administratore: Fidelma Donlon

Data: 17 tetor 2025

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Publik

**Vendim mbi Kërkesën e Kilajt për Zgjatje të Afatit për Dorëzimin
e Dosjes Paraprake të Mbrojtjes**

Prokurores së Specializuar
Kimbërli P. Uest

Mbrojtjes së Hashim Thaçit
Sofi Menegon
Luka Mishetiq

Mbrojtjes së Bashkim Smakajt
Xhonatan Ris
Hju Bauden

Mbrojtjes së Isni Kilajt
Ian Eduards
Xho Holms

Mbrojtjes së Fadil Fazliut
Dejvid Jang

Mbrojtjes së Hajredin Kuçit Aleksandër
Admiral

GJYKATËSJA E PROCEDURËS PARAPRAKE,¹në bazë të nenit 39(13) të Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar ("Ligji") dhe rregullave 9(5)(a), 76, 82(5), dhe 95(2), (4) dhe (5) të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës ("Rregullorja"), lëshon këtë vendim.

I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 25 korrik 2025, Gjykatësja e Procedurës Paraprake, ndër të tjera, informoi Mbrojtjen se ajo synonte të caktonte afatin për dorëzimin e dosjeve paraprake përkatëse më 20 tetor 2025.²

2. Më 4 gusht 2025, pas kërkesës për sqarim prej Mbrojtjes së Isni Kilajt ("z. Kilaj"), Gjykatësja e Procedurës Paraprake sqaroi se ajo synonte të caktonte përfundimisht afatin për dorëzimin e dosjeve paraprake të Mbrojtjes për 20 tetor 2025 në një urdhër tjetër, në varësi, ndër të tjera, të parashtrimeve të Mbrojtjes lidhur me këtë aspekt.³

3. Më 16 shtator 2025, Gjykatësja e Procedurës Paraprake e ftoi Mbrojtjen të dorëzonte dosjet paraprake përkatëse deri më 20 tetor 2025 dhe informoi palët se ajo synonte t'ia kalojë çështjen Trupit Gjykues në gjysmën e parë të nëntorit 2025.⁴

4. Më 16 tetor 2025, Mbrojtja e z. Kilaj ("Mbrojtja e Kilajt") parashtrroi Kërkesën e Mbrojtjes së Kilajt për Zgjatje të Afatit për Dorëzimin e Dosjes Paraprake të Saj ("Kërkesa").⁵

¹KSC-BC-2023-12, F00015, Kryetarja, *Vendim për Caktimin e Gjykatëses së Procedurës Paraprake*, 6 qershor 2024, publik.

²KSC-BC-2023-12, F00395, Gjykatësja e Procedurës Paraprake, *Urdhër në lidhje me Kalendarin për Pjesën e Mbetur të Procedurës Paraprake*, 25 korrik 2025, publik, para. 18(d).

³ KSC-BC-2023-12, CRSPD101, 4 gusht 2025, konfidenciale.

⁴ KSC-BC-2023-12, F00453, Gjykatësja e Procedurës Paraprake, *Vendim për Kalendarin e Mbetur të Fazës Paraprake*, 16 shtator 2025, publik, para. 23(a) dhe (e).

⁵KSC-BC-2023-12, F00503, Mbrojtja e Kilajt, *Kërkesë e Mbrojtjes së Kilajt për Ndryshimin e Afatit për Dorëzimin e Dosjes Paraprake të Saj*, 16 tetor 2025, publike.

5. Më 17 tetor 2025, pasi Gjykatësja e Procedurës Paraprake ndryshoi afatin për dorëzimin e parashtrimeve, ⁶Mbrojtja e Hashim Thaçit ("Mbrojtja e Thaçit"), Mbrojtja e Hajredin Kuçit ("Mbrojtja e Kuçit") dhe Zyra e Prokurorit të Specializuar ("ZPS") iu përgjigjën Kërkesës.⁷

II. PARASHTRIMET

6. Mbrojtja e Kilaj parashtron se, më 15 tetor 2025, ajo u informua nga ZPS-ja, ndër të tjera, se ajo do të merrte, më 17 tetor 2025, një kopje të plotë forenzike të telefonit iPhone 12 të z. Kilaj dhe se ZPS-ja do të fillonte më pas rishqyrtimin e relevancës së telefonit iPhone dhe do të nxirrte menjëherë të gjithë materialin e identifikuar sipas rregullave 102(1)(b) dhe/ose 102(3) të Rregullores ("Njoftimi i ZPS-së").⁸ Duke marrë parasysh këtë zhvillim, Mbrojtja e Kilajt argumenton se ekzistojnë shkaqe bindëse për të kërkuar zgjatje të afatit për dorëzimin e dosjes paraprake të saj, pasi: (i) në varësi të procesit të rishqyrtimit të ZPS-së, provat mbi të cilat është bazuar ZPS-ja për të mbështetur argumentet e veta kundër z. Kilaj mund të ndryshojnë;⁹ (ii) ZPS-ja mund të dorëzojë një shtesë të dosjes paraprake të saj lidhur me të cilën Mbrojtjes duhet t'i jepet mundësia që të përgjigjet;¹⁰ dhe (iii) Mbrojtja nuk është e detyruar të dorëzojë një dosje paraprake dhe nëse nuk miratohet zgjatja e afatit, ajo thjesht nuk do ta bëjë këtë.¹¹ Si rezultat, Mbrojtja e Kilajt i kërkon Gjykatësës së Procedurës Paraprake të ndryshojë afatin për dorëzimin e dosjes paraprake të saj shtatë (7) ditë pasi ZPS-ja të përfundojë nxjerrjen e të gjithë materialeve të reja sipas rregullave 102(1)(b), 102(3) dhe/ose 103 të

⁶ KSC-BC-2023-12, CRSPD145, 16 tetor 2025, konfidenciale.

⁷ KSC-BC-2023-12, F00506, Mbrojtja e Thaçit, *Përgjigje e Mbrojtjes së Thaçit ndaj Kërkesës së Mbrojtjes së Kilajt për Ndryshimin e Afatit për Dorëzimin e Dosjes Paraprake të Saj, (F00503) ("Përgjigja e Thaçit")*, 17 tetor 2025, publike. F00507, Prokurori i Specializuar, *Përgjigja e Prokurorisë ndaj Kërkesës së Mbrojtjes së Kilajt për Ndryshimin e Afatit për Dorëzimin e Dosjes Paraprake të Saj, (F00503) ("Përgjigja e ZPS-së")*, 17 tetor 2025, publike. F00508, F00420, Mbrojtja e Kuçit, *Parashtrim i Mbrojtjes së Kuçit në Lidhje me Parashtrimin F00503 të Mbrojtjes së Kilajt ("Përgjigja e Kuçit")*, 17 tetor 2025, publike.

⁸ Kërkesa, para. 2. *Shih gjithashtu KSC-BC-2023-12, F00499, Prokurori i Specializuar, Njoftim i Prokurorisë në Lidhje me Parashtrimin F00420, 15 tetor 2025, publik.*

⁹ Kërkesa, para. 6.

¹⁰ Kërkesa, para. 7.

¹¹ Kërkesa, para. 8.

Rregullores dhe të dorëzojë shtesën e dosjes paraprake të saj, ose të konfirmojë se nuk do të dorëzojë një shtojcë të tillë.¹²

7. Mbrojtja e Thaçit i bashkohet Kërkesës, për të njëjtat arsye të përshkruara në të, dhe kërkon që afati të ndryshohet edhe për Mbrojtjen e Thaçit.¹³

8. Mbrojtja e Kuçit gjithashtu i bashkohet Kërkesës, për të njëjtat arsye të përshkruara në të, duke shtuar se: (i) ajo ende pret raportin përfundimtar të Mbrojtëses së Pavarur lidhur me pajisjet e sekuestruara nga Hajredin Kuçi ("z. Kuçi");¹⁴ dhe (ii) hetime të tjera aktuale mund të rezultojnë relevante për mbrojtjen e z. Kuçi.¹⁵

9. ZPS-ja parashtron se Mbrojtja e Kiljat nuk paraqet arsye bindëse për shkak se: (i) as rregulla 95(4) as rregulla 95(5) e Rregullores nuk kërkon nxjerrjen e çdo prove mbi të cilën do të bazohet ZPS-ja në gjykim;¹⁶ (ii) pretendimi se nga telefoni iPhone 12 i z. Kilaj do të nxirren prova është hamendësues;¹⁷ (iii) dosja paraprake e ZPS-së jep informacion të nevojshëm në mënyrë që z. Kilaj të përcaktojë pistat e përgjithshme të mbrojtjes së tij, dhe të identifikojë akuzat dhe aspektet që ai kundërshton dhe dëshmitarët e mundshëm që ai synon të thërrasë;¹⁸ dhe (iv) Mbrojtja është në dijeni të orvatjeve të vazhdueshme të ZPS-së për qasje në telefonin iPhone 12 të z. Kilaj dhe autorizimeve të Gjykatëses së Procedurës për veprime hetimore me cak konkret të ZPS-së.¹⁹ Për rrjedhojë, ZPS-ja kërkon rrëzimin e Kërkesës.

¹² Kërkesa, para. 9.

¹³ Përgjigjja e Thaçit, para. 1-2.

¹⁴ Përgjigjja e Kuçit, para. 5-6.

¹⁵ Përgjigjja e Kuçit, para. 6.

¹⁶ Përgjigjja e ZPS-së, para. 2.

¹⁷ Përgjigjja e ZPS-së, para. 3.

¹⁸ Përgjigjja e ZPS-së, para. 3.

¹⁹ Përgjigjja e ZPS-së, para. 4.

III. DISPOZITAT LIGJORE PËRKATËSE

10. Sipas nenit 39(13) të Ligjit, kur është e nevojshme, me nismën e vet, Gjykatësja e Procedurës Paraprake mund të lëshojë çdo urdhër tjetër që mund të jetë i nevojshëm për përgatitjen e një gjykimi të drejtë dhe të shpejtë.
11. Në pajtim me rregullën 95(2) të Rregullores, Gjykatësja e Procedurës Paraprake sigurohet që procedura paraprake të mos ketë vonesa të papërligjura dhe merr masat e nevojshme për përgatitjen e shpejtë të çështjes për gjykim.
12. Në pajtim me rregullën 95(4) të Rregullores, Gjykatësja e Procedurës Paraprake urdhëron ZPS-në të paraqesë: (a) dosjen paraprake të Prokurorit të Specializuar; (b) listën e dëshmitarëve që Prokurori i Specializuar synon të thërrasë; dhe (c) listën e provave materiale të propozuara që Prokurori i Specializuar synon të paraqesë, ku përfshihet, kurdoherë që është e mundshme, çfarëdo kundërshtimi të Mbrojtjes lidhur me autenticitetin e tyre.
13. Në pajtim me rregullën 95(5) të Rregullores, pas dorëzimit të materialeve të përmendura në rregullën 95(4) të Rregullores, Gjykatësja e Procedurës Paraprake fton Mbrojtjen që brenda një afati të përcaktuar të dorëzojë dosjen paraprake.
14. Në pajtim me rregullën 9(5)(a) të Rregullores, *proprio motu* ose nëse i tregohen arsye të vlefshme, Gjykatësja e Procedurës Paraprake mund të zgjasë ose shkurtojë afatet e përcaktuara prej kësaj Rregulloreje ose prej panelit.
15. Në pajtim me rregullën 76 të Rregullores, kërkesa për zgjatje të afatit paraqitet në kohë të mjaftueshme paraprakisht për t'i mundësuar panelit marrjen e vendimit në lidhje me kërkesën para përfundimit të afatit përkatës.
16. Në pajtim me rregullën 82(5) të Rregullores, Gjykatësja e Procedurës Paraprake mund të ndryshojë statusin e një parashtrimi të protokolluar, me kërkesë të një pjesëmarrësi tjetër në proces, apo *proprio motu*.

IV. DISKUTIM

17. Gjykatësja e Procedurës Paraprake vë në dukje se Kërkesa u dorëzua menjëherë pas Njoftimit të ZPS-së. Në këto rrethana konkrete, Gjykatësja e Procedurës Paraprake konstaton se Kërkesa është dorëzuar mjaftueshëm në kohë, në përputhje me rregullën 76 të Rregulloers.

18. Përpara se të trajtojë parashtrimet e Kilajt në lidhje me arsyet bindëse, Gjykatësja e Procedurës Paraprake rikujton se: (i) Mbrojtja e Kilajt është në dijeni që prej sekuestrimit të telefonit iPhone 12 rë z. Kilaj²⁰ se telefoni i tij do t'i nënshtrohet analizës forenzike, përmbajtja e tij do të rishqyrtohet nga ZPS-ja, dhe informacioni i nxjerrë prej tij me shumë gjasa do të nxirret; (ii) ekipet e Mbrojtjes janë në dijeni të datës së parashtrimit të dosjeve paraprake të Mbrojtjes që prej 25 korrikut 2025, kur ato u informuan për herë të parë;²¹ (iii) kjo datë i është konfirmuar Mbrojtjes së Kilajt (dhe ekipeve të tjera të Mbrojtjes) në dy raste;²² (iv) ZPS-ja dorëzoi dosjen paraprake të saj, së bashku me listën e dëshmitarëve dhe listën e provave materiale në të cilat synon të bazohet në gjykim, më 19 shtator 2025;²³ dhe (viii) Gjykatësja e Procedurës Paraprake informoi palët se ajo synon t'ia kalojë çështjen trupit gjykues në gjysmën e parë të nëntorit 2025, në qoftë se kjo lejohet nga vendimet e ardhshme të Panelit të Gjykatës së Apelit mbi apelet e paraqitura në lidhje me mocionet paraprake.²⁴

²⁰ KSC-BC-2023-12, INV/F00056/COR2/CONF/RED, Prokurori i Specializuar, *Version i Redaktuar Konfidencial i Versionit të Korrigjuar të Raportit të Prokurorisë sipas Vendimit F00484 me Shtojcat Rreptësisht Konfidenciale dhe ex parte 1 deri në 4 KSC-BC-2018-01/F00515/COR*, 16 nëntor 2023 (data e versionit të redaktuar konfidencial 27 shkurt 2025), konfidencial, para. 25; *Shih më tej* INV/F00117, Prokurori i Specializuar, *Kërkesë e Prokurorisë për Mbajtje të Provave (F00611)*, 24 prill 2024, konfidenciale, para. 4.

²¹ *Shih* para. 1 më lart.

²² *Shih* para. 2-3 më lart.

²³ KSC-BC-2023-12, F00459, Prokurorja e Specializuar, *Parashtrim prej Prokurorisë i Dosjes Paraprake, Listës së Dëshmitarëve dhe Listës së Provave Materiale*, 19 shtator 2025, publik, me Shtojcat 1-5, konfidenciale. Versioni i korrigjuar i Dosjes Paraprake të ZPS-së, së bashku me Shtojcat konfidenciale 1-5, u dorëzuan më 26 shtator 2025, F00467. Versioni i korrigjuar i Dosjes Paraprake të ZPS-së, së bashku me Shtojcat konfidenciale 1-5, u dorëzuan më 6 tetor 2025 duke dhënë hollësi në një shënim shpjegues korrigjimet e bëra në dosjen paraprake të ZPS-së dhe Shtojcën 4 (Listën e Provave Materiale), F00459/COR. Versioni i redaktuar publik i Aktakuzës së Konfirmuar u dorëzua më 7 tetor 2025, F00489, me Shtojcën 1, publike.

²⁴ *Shih* Vendimin mbi Kalendarin, para. 21.

19. Duke iu kthyer argumentit të Mbrojtjes së Kilajt se provat e ZPS-së në mbështetje të argumenteve të saj kundër z. Kilaj mund të ndryshojnë, Gjykatësja e Procedurës Paraprake është e mendimit se Mbrojtja e Kiljat e ka gabim. “Argumentet” kundër z. Kilaj janë përcaktuar në aktakuzën e konfirmuar të ndryshuar,²⁵ dosjen paraprake të ZPS-së dhe materialet lidhur me to,²⁶ të plotësuara nga vendimi për konfirmimin e aktakuzës dhe ndryshimin e saj,²⁷ tabela e ZPS-së sipas rregullës 109(c),²⁸ provat e nxjerra deri tani në çështje gjyqësore,²⁹ dhe përmbledhjen sipas rregullës 86(3)(b).³⁰ Disa materiale në çështjen gjyqësore aktuale të sekuestruara nga të akuzuarit dhe të mbrojtura me fjalëkalim, të cilin disa të akuzuar zgjodhën të mos e jepnin vullnetarisht, përfshijnë një analizë të instituteve të jashtme forenzike, e cila, nga ana e saj, ndikon progresin e nxjerrjes së provave. Megjithatë, çdo provë shtesë (e mundshme) që do të nxirret gjatë rishqyrtimit të telefonit iPhone 12 të z. Kilaj nga ZPS-ja ose çdo provë tjetër që do të nxirret dhe në të cilën ajo do të bazohet sipas rregullës 102(1)(b) të Rregullores, në këtë fazë, mund të konsiderohet vetëm plotësuese dhe nuk ndryshon përmbajtjen dhe natyrën e akuzave.³¹ Çdo provë shfajësuese e mundshme që do të nxirret sipas rregullës 102(3) ose 103 të Rregullores,

²⁵KSC-BC-2023-12, F00264, Prokurorja e Specializuar, *Parashtrim i Aktakuzës së Konfirmuar të Ndryshuar*, 16 prill 2025, publik, me Shtojcën 1, konfidenciale (që përfshin versionin konfidencial të Aktakuzës së Konfirmuar të Ndryshuar), dhe Shtojcën 2, publike (që përfshin versionin e redaktuar publik të Aktakuzës së Konfirmuar të Ndryshuar).

²⁶*Shih* poshtëshënimin 23 më lart.

²⁷ KSC-BC-2023-12, F00036, Gjykatësja e Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Konfirmimin e Aktakuzës*, 29 nëntor 2024, konfidencial. Versioni i redaktuar publik u dorëzua më 12 shkurt 2025, F00036/RED. F00260, Gjykatësja e Procedurës Paraprake, *Vendim për Ndryshimin e Vendimit mbi Konfirmimin e Aktakuzës dhe Caktimin e Datës për Dorëzimin e Mocioneve Paraprake*, 14 prill 2025, publik.

²⁸ KSC-BC-2023-12, F00488, Prokurorja e Specializuar, *Parashtrimi prej Prokurorisë i Tabelës Sipas Rregullës 109(c)*, 6 tetor 2025, publik, me Shtojcën 1, konfidenciale.

²⁹Gjykatësja e Procedurës Paraprake rikujton se ZPS-ja ka nxjerrë gjithsej 74 paketa të materialeve për Mbrojtjen: gjashtë (6) paketa përmbajnë material sipas rregullës 102(1)(a); njëzet e pesë (25) paketa të materialit të nxjerrë përmbajnë material sipas rregullës 102(1)(b); njëzet e nëntë (29) paketa të materialit të nxjerrë përmbajnë material sipas rregullës 102(3); katërmbëdhjetë (14) paketa të materialit të nxjerrë përmbajnë material sipas rregullës 103.

³⁰KSC-BC-2023-12, F00028/A02, Prokurori i Specializuar, *Shtojca 2 e Parashtrimit të Aktakuzës së Ndryshuar të Konfirmuar*, 12 nëntor 2024, konfidenciale.

³¹KSC-BC-2023-12, F00509, Gjykatësja e Procedurës Paraprake, *Vendim për Autorizimin e Nxjerrjes së Materialit sipas Rregullës 102(1)(b) të Rregullores*, 17 tetor 2025, publik.

duhet dhe do të diskutohet gjatë gjykimit. I njëjti arsyetim vlen për argumentet e ngritura nga Mbrojtja e Kuçit në lidhje me rishqyrtimin aktual të pajisjeve të z. Kuçi dhe “hetimet e tjera akutale”.³²

20. Sa i takon argumentit të Mbrojtjes së Kilajt se ZPS-ja mund të dorëzojë një shtesë të dosjes paraprake të saj (ose *proprio motu* ose me urdhër të Gjykatësës së Procedurës Paraprake, Gjykatësja e Procedurës Paraprake e konsideron këtë hamendësuese dhe të parakohshme në këtë fazë. Në çdo rast, nëse kërkohet një ndryshim i tillë, Trupi Gjykues kompetent do të marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar drejtësinë e procesit dhe të drejtat e të akuzuarve. Për këtë arsye, nuk është e nevojshme që të urdhërohet ZPS-ja në këtë fazë që të dorëzojë shtesë të dosjes paraprake të saj, ose të konfirmojë se ajo nuk do të dorëzojë shtesë.

21. Sa i takon argumentit të Mbrojtjes së Kilajt se ajo mund të mos dorëzojë dosje paraprake nëse kërkesa për zgjatje afati nuk miratohet, Gjykatësja e Procedurës Paraprake rikujton se Mbrojtja nuk e ka detyrim që të dorëzojë dosje paraprake. Është në zgjedhjen e saj që të mos dorëzojë dosje paraprake fare.

22. Duke marrë parasysh sa më lart, Gjykatësja e Procedurës Paraprake nuk bindet se Mbrojtja e Kilajt ka treguar arsye bindëse për ndryshimin e afatit për dorëzimin e dosjes paraprake të saj. Të njëjtat arsye vlejné edhe për kërkesat e Mbrojtjes së Thaçit dhe Mbrojtjes së Kuçit për ndryshimin e afatit për dosjet paraprake të tyre.

23. Për rrjedhojë, afati për Mbrojtjen për dorëzimin e dosjeve paraprake të tyre, nëse dëshirojnë të dorëzojnë dosje paraprake, mbetet të **hënën, 20 tetor 2025**.

24. Së fundi, duke vërejtur kërkesën e ZPS-së për riklasifikim të përgjigjes së saj si publike,³³ dhe duke qenë e bindur se informacioni i përfshirë në të mund të jetë publik, Gjykatësja e Procedurës Paraprake urdhëron Zyrën Administrative që të riklasifikojë parashtrimin F00507 si publik, në përputhje me rregullën 82(5) të Rregullores.

³²Përgjigjja e Kuçit, para. 5-6.

³³ Përgjigjja e ZPS-së, para. 5.

V. VENDIM

25. Për arsyet e lartpërmendura, Gjykatësja e Procedurës Paraprake:

- a. **RRËZON** Kërkesën;
- b. **RIKUJTON** ftesën e saj për Mbrojtjen për dorëzimin e dosjeve paraprake të tyre, nëse dëshirojnë , **deri të hënën, 20 tetor 2025.** dhe
- c. **URDHËRON** Zyrën Administrative ta riklasifikojë Përgjigjen (F00507) si publike.

/nënshkrimi/

Gjykatëse Marzhor Masëlo
Gjykatëse e Procedurës Paraprake

E premte, 17 tetor 2025

Në Hagë, Holandë